



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Planet e punës së Drejtorisë për kulturë për periudhën Janar- Mars 2012

SEKTORI I KULTURËS

- Projekti: “17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës”- Akademi e përcjellë me program artistik
- Projekti : “7 Marsi, dita e mësuesit”është shënuar me hapjen e një ekspozite dhe manifestimi letrar
- Projekti: “8 Marsi – dita e gruas”- përcjellë me manifestime letrare
- Manifestime kulturore në kuadër të shënimit të 100 vjetorit të shtetit shqiptar
- Projekte teatrore nga Teatri Profesionist dhe teatrot amatore(“Nura- Bejtullahu- Domi”dhe “Fëmijët në skenë”).
- Promovime të librash – Jusuf Buxhovi promovoi veprën “ Kosova “dhe 5 vepra të tjera të autorëve vendorë dhe nga Shqipëria
- Ekspozita pikturash- janë organizuar 3 ekspozita të pikturave
- Tribuna dhe orë letrare, janë mbajtur katër manifestime letrare, në vazhden e përvjetori të Pavarësisë së Shqipërisë

BIBLIOTEKA

- Biblioteka paresh regjistrimet e anëtarëve të rinj në një numër mbi 3000 anëtarë të të gjitha kategorive të lexuesve.
- Si gjithnjë, në bashkëpunim të mirë me shkollat fillore dhe të mesme, edhe këtë vit parashihet të ketë lexues nga shkollat si dhe nga Fakultetet me veprim në Gjakovë. Edhe më tej Këshilli I bibliotekës, ka të liruar nga pagesa kategoritë me dëme nga lufta dhe pensionistët, të shtyrë në moshë mbi 65 vjeçar. Pasurimin me fondin librar e kemi primare këtë vit dhe pritët të ketë hyrje nga fondi librar më shumë se vitin e kaluar.
- Pasurimi bëhet vetëm nga Komuna e Gjakovës dhe nga donatorët, siç janë botuesit dhe autorët e librave.
- Po ashtu edhe aktivitetet kulturore janë të parapara të mbahen në periudha, duke planifikuar 15 aktivitete.

TEATRI PROFESIONAL JANAR –Mars 2012

- Përgatitjet e nevojshme dhe fillimi i provave i projektit teatror:

1.“ Mbretëresha e bukur nga Lenon””- autor: Martin Mc Donagh. Reegjia: Ilir Bokshi.

MUZEU RAJONAL - Gjakovë

Programi i punës për periudhën janar - mars 2012Muzeu Rajonal veprimtarinë e vet e mbështet në tri seksione: Histori, Etnograf, Arkeologji. Dhe me punën e tyre krijojnë kushte që të mirat kulturore të trashëgimisë të ruhen, në mënyrë që tu shërbejnë nevojave shkencore dhe edukative të mbarë shoqërisë. Puna zhvillimore e veprimtarisë në kuadër të vitit kalendarik 2012 do të mbështetet në hulumtimin mbledhjen dhe përpunimin e materialit që është, dhe që do të hyjë në Muze .Ky proces vazhdon gjithnjë, sepse është gjithmonë prioriteti i parë në punën Mbledhja hulumtimi dhe përpunimi i materialit MuzeorDo fokusohemi në hulumtimin dhe plotësimin e fondeve, përpunimin e materialit të sektorëve tona, inventarizimin dhe bartjen e tyre në CD , këto do renditen në fonde,në mënyrë që të jenë të gatshme për ekspozim.

Konservimi dhe restaurimi i materialit Muzeor

Objektet e trashëgimisë kulturore kanë tretman të veçantë. Ruajtja bëhet nga ekspertet e shkolluar, e që në Kosovë as që i kemi. Prandaj ne jemi të detyruar të ndërmarrim vet ruajtjen e tyre, dhe këtë vetëm për eksponatet e etnografisë – tekstilin.

I. Sektori i historisë

Fondi i këtij sektori është i pasur, por do bëjmë përpjekje ta pasurojmë edhe më shumë gjatë hulumtimeve., si dhe kujdesi kryesor do ti kushtohet inventarizimit dhe përpunimit të tyre. Materiali i përpunuar dhe i klasifikuar do të shpërndahet nëpër fonde dhe do të përcillet në CD.

II. Sektori i etnografisë

Ne e kemi cekur vazhdimisht në programet tona të punës plotësimin e fondeve të këtij sektori, në mënyrë që të kemi një ekspozitë të përhershme. Për të realizuar këtë nevojë na duhen mjete financiare. Ndoshta do të kishte qenë mirë që kujdesi të jetë më i shtuar nga ana e drejtorisë për Muzeun. Kërkojmë që të na bëhet e mundur një fond për rarite .

SEKTORI I RINISË

Pjesëmarrja e të rinjve –Objektivat: Të organizohen fushata për ngritjen e vetëdijes së të rinjve për rolin e tyre në vendimmarrje, të përkrahet Qendra Rinore dhe KVRL, të ngrihet kapaciteti i OJQ-ve rinore, të përkrahen Këshillat e nxënësve të shkollave të mesme.

Edukimi- Objektivat: Organizimi i trajnime joformale, organizimi i debateve me nxënës rreth problemeve dhe preokopimeve të nxënësve, qasja e veçanta tek grupet e marginalizuara.

Punësimi- Objektivat : Informimi i të rinjve për punësim, ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i të rinjve për punësim.

SEKTORI I SPORTIT

Në kuadër të drejtorisë për kulturë rini e sport sektori i sportit Gjate vitit 2012 ka planifikuar të realizojë një kompleks të gjere të aktiviteteve Sportive sipas kësaj dinamike siç vijon ;

I. Aktivitetet e klubeve sportiv e me sistem të rregullt garash

II . Aktivitetet e klubeve sportive me sistem stinor

III.. Aktivitetet e shkollave sportive

IV. Aktivitetet sportive të karakterit masovik

V. Aktivitetet sportive memoriali

VI. Realizimi i projektit - fusha e futbollit

VII. Realizimi i projektit - pallati i sporteve ‘Shani Nushi ‘

VIII. Shfrytëzimi i orëve të rekreacionit trajningjeve dhe ndeshjeve kampionale.

Klubet sportive me sistem të rregullt garash

super liga - stinori vjeshtor - pranveror

1. Klubi i futbollit ‘ Vellaznimi ‘

2. Klubi i hendbollit ‘ Vellaznimi ‘ /meshkujt/

3. Klubi i hendbollit ‘ Vellaznimi ‘ /femrat /

4. Klubi i hendbollit ‘ Shqiponja ‘ / femrat /

5. Klubi i basketbollit ‘ Vellaznimi ‘ / femrat /

6. Klubi i futsallit ‘ Liburn.